



## **POLITIKA PËR MBROJTJEN E TË MITURVE DHE TË RINJVE GJIMNAZI “ATË PJETËR MESHKALLA”**

Gjimnazi privat “Atë Pjetër Meshkalla” i drejtuar nga etërit jezuitë dhe pjesë e **Fondacionit “Gesuiti Educazione”** ofron një edukim cilësor, gjithëpërfshirës, dhe të ndjeshëm ndaj problematikave të shoqërisë shqiptare dhe sfidave të të rinjve.

Gjimnazi privat “Atë Pjetër Meshkalla” është gjithashtu pjesë e rrjetit të Komisionit të **Edukimit Katolik Shqiptar (KKEKSH)**.

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve në gjimnazin “Atë Pjetër Meshkalla” mbështetet në dokumentacionet e hartuara në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe udhëzimet e **KKEKSH**, si dhe integron praktikën më të mira të marra nga takimet e formimit të vazhdueshëm, të organizuara nga Fondacioni “Gesuiti Educazione” dhe **JECSE**.

### **1. Qëllimi i Politikës së Mbrojtjes.**

Politika e Mbrojtjes ka për qëllim ndërtimin e një sistemi të brendshëm parandalimi dhe mbrojtje tërësore nga çdo formë abuzimi dhe rrishtu të mundshëm që mund t’iu kanoset të gjithë nxënësve të shkollave katolike shqiptare, përfshirë nxënësit nën moshën 18 vjeç si dhe nxënësit që kanë arritur moshën madhore, të cilët mund të konsiderohen akoma si të rinj vulnerabël.

### **2. Figurat profesionale të parashikuara:**

Politika e Mbrojtjes parashikon dy figura specifike për mbrojtjen e të miturve dhe të rinjve, të cilët punojnë për të mbështetur figurat e tjera profesionale të përfshira në shkolla:

1. **Përfaqësuesi** për mbrojtjen e të miturve dhe të rinjve të emëruar nga KKEKSH.
2. **Referenti i shkollës** për mbrojtjen e të miturve dhe të rinjve, i caktuar nga vetë shkolla.

**Personi Referent i shkollës për mbrojtjen e të miturve dhe të rinjve**

<b>Profili i referentit</b>	<b>Përshkrimi i punës</b>
<p>Të jetë me profil mësues/punonjës social/psikolog në shkollën ku ai punon</p> <p>Të ketë së paku 3 vjet eksperiencë si mësues/punonjës social/psikolog</p> <p>Të zotërojë gjuhën shqipe</p> <p>Emërohet nga përfaqësuesi ligjor i entit që menaxhon institucionin edukativ</p> <p>Sygjerohet të mos ushtrojë detyrën e Drejtuesit të Institucionit Arsimor</p> <p>Të ketë përfunduar një trajnim fillestar mbi Politikën nga KKEKSH</p> <p>Merr pjesë aktivisht në trajnimet e organizuara nga KKEKSH</p> <p>Të paraqesë integritet dhe pjekuri si në jetën profesionale ashtu edhe në atë private</p> <p>Të mos ketë historik të abuzimit me fëmijë, apo të jetë përfshirë në situata shqetësuese në lidhje me mbrojtjen e të miturve.</p>	<p>Koordinon miratimin fillestar dhe përditësimin vjetor sipas rastit, të politikës, në bashkëpunim me KKEKSH</p> <p>Lehtëson menaxhimin dhe zbatimin e të gjitha masave të parashikuara nga Politika e Mbrojtjes në bashkëpunim me drejtuesin e institucionit.</p> <p>Vepron si një pikë kontakti ndërmjet shkollës dhe përfaqësuesit të KKEKSH-it</p> <p>Koordinon intervistat dhe takimet me të miturit, familjarët dhe personelin e shkollës për të gjitha temat që lidhen me Politikën e Mbrojtjes dhe Procedurën e Menaxhimit të rasteve</p> <p>Merr nga palët e interesuara (nxënësit, familja, rregulltarët, punonjësit dhe bashkëpunëtorët e jashtëm) me shkrim ose në formë verbale sinjalizime për shqetësime në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve, sipas Procedurës së Menaxhimit të rasteve dhe sipas rastit mund të konsultohet me Përfaqësuesin e KKEKSH.</p>

Të jetë i/e hapur dhe pa paragjytime raciale, fetare, krahinore, gjinore apo të tjera

Të ketë aftësi të mira përshtatjeje me grupe të moshave e niveleve të ndryshme.

Të jetë i/e aftë të krijojë dhe mbajë të qëndrueshme marrëdhëniet.

Të ketë aftësi në vendosjen e prioriteteve në mënyrë të efektshme dhe zbatimin e detyrave në një ambient nën tryzni të lartë.

Të ketë aftësi ndërpersonale dhe në menaxhimin/zgjidhjen e konflikteve.

Të ketë njohuri të mirë të paketës Windows, dhe të programeve Word, Excel, Powerpoint, Internet etj.

Të ketë aftësi të mira në përpilimin e dokumentacioneve të ndryshme.

Vlerëson dhe menaxhon rastin e të miturit, të riut në nevojë për mbrojtje

Është përgjegjës për dokumentimin, arkivimin e ruajtjen e të dhënave për rastet e menaxhuara

Të ruajë konfidencialitetin e të dhënave gjatë procedurës së menaxhimit të rasteve

Përcakton veprimet/ masat që do të ndërmerren për sigurimin e mbrojtjes.

Garanton që masat e parashikuara të ofrohen nga palët e treta të përfshira në mbrojtjen e të miturit dhe të riut

Të zhvillojë takime sensibilizuese në kuadër të Politikës së mbrojtjes së fëmijëve me nxënësit, stafin e shkollës si dhe prindërit gjithashtu.

Koordinon aktivitetin e mbledhjes së pyetësorëve të kërkuar nga kjo Politikë e Mbrojtjes për të gjithë komponentët e institucionit edukativ.

Është përgjegjës në rastet e largimit nga detyra për shoqërimin e Referentit të ri duke respektuar kriteret e Procedurës së Orientimit të Referenteve të rinj në një kohështrirje prej 2 javësh.

### 3. Referencat ligjore ku bazohet Politika e Mbrojtjes

Politika e Mbrojtjes është konceptuar si një sistem menaxhimi, me qëllim përkthimin e parimeve të përgjithshme që e frymëzojnë atë në procedura specifike sjelljeje për personelin e shkollave të rritet që punojnë në marrëdhënie me të miturit dhe të rinjtë.

Për këtë arsye, në zhvillimin e Politikës së Mbrojtjes përveç legjislacionit shqiptar dhe atij ndërkombëtar janë marrë në konsideratë standartet ndërkombëtare të mbrojtjes, të vendosura nga Koalicioni në Mbrojtje të Fëmijëve, të cilat njihen nga organizata dhe donatorë ndërkombëtarë me reputacion, përfshirë Komisionin Europian, si dhe standartet ndërkombëtare të normave vullnetare që përcaktojnë karakteristikat e përgjithshme të sistemeve të menaxhimit:

1. UNI EN ISO 9000 Sistemet e menaxhimit të cilësisë - Baza dhe fjalori
2. UNI EN ISO 9001 Sistemet e menaxhimit të cilësisë – Kriteret
3. UNI EN ISO 19011 Udhëzime për Monitorimin e sistemit të menaxhimit
4. UNI ISO 31000 Menaxhimi i riskut - Parimet dhe udhëzimet.

Struktura e Politikës së Mbrojtjes gjithashtu përfshin edhe tekstin e normave vullnetare për parandalimin dhe luftën kundër bullizmit, i cili ka hyrë fuqi në Itali që nga data 1 Gusht 2018, PdR UNI 42/18<sup>1,2</sup> duke marrë parasysh edhe ko incidencën e pjesshme të temave, por duke e zgjeruar qasjen e saj (e cila trajton vetëm bullizmin) me të gjitha format e tjera të mbrojtjes së të miturve dhe të rinjve.

Në zhvillimin e Politikës së Mbrojtjes, një rol thelbësor i takon "Politikës së Mbrojtjes" të miratuar nga KKEKSH që në vitin 2017<sup>3</sup> me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtarë, parimet themelore e të cilave janë marrë dhe zhvilluar brenda kësaj Politike.

---

<sup>1</sup>Zgjedhja e UNI 42 PdR si model reference rrjedh në veçanti nga karakteristikat e mëposhtme:

- është një sistem menaxhimi në përputhje me rregullat teknike ndërkombëtare për standardizimin vullnetar;
- është promovuar nga institucionet kishtarë italiane (megjithëse i referohet të gjitha enteve që strehojnë të mitur, duke përfshirë edhe ata jo-katolike);
- u konceptua të jetë i zbatueshëm në çdo rajon të botës dhe në fakt u botua si në italisht ashtu edhe në anglisht;
- duke u strukturuar si një sistem menaxhimi, është hartuar për të lejuar kontrollin e zbatimit të tij nga palët e jashtme në lidhje me institucionet individuale që e zbatojnë atë;

<sup>2</sup>Udhëheqësi i projektit të PdR UNI 42 përkon me ekspertin ndërkombëtar të cilit iu besua mbështetja profesionale për përcaktimin e një sistemi të mbrojtjes së fëmijëve në shkollat katolike shqiptare.

<sup>3</sup> Për këtë arsye ndërhyrja e Ekspertes austriake Astrid Winkler e organizatës Ecpat, ka qenë shumë e vyer si në hartimin e SGP të Komisionit po ashtu edhe në shoqërimin e punës të ekspertëve vendas për të garantuar respektimin e kritereve bazë të standardeve ndërkombëtare të SGP.

Politika e Mbrojtjes është hartuar në përputhje të plotë dhe me normativat ndërkombëtare, siç është “Konventa për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve” e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989, dhe e ratifikuar nga Shteti Shqiptar me Ligjin Nr. 7531, datë 11.12.1991<sup>4</sup>, Ligj nr. 108/2012 datë 15.11.2012 Për ratifikimin e konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”<sup>5</sup>.

Së fundmi, kjo Politikë e Mbrojtjes njeh dhe rregullohet sipas legjislacionin shqiptar, ndaj është hartuar pjesa e tretë ku përmbledhet *“Kquadri Ligjor Për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve”* e cila përmban të gjitha referencat rregulluese që duhen përditësuar vazhdimisht. Të gjitha shkollat e rrjetit duhet t’i aplikojnë në mënyrë korrekte, si një parakusht i domosdoshëm për t’u certifikuar konform kriterëve dhe rregullave që kjo Politikë e Mbrojtjes ofron për zbatimin e saj.

Konkretisht:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 18/2017 "Për Mbrojtjen dhe të Drejtat e Fëmijëve si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij" (Vkm nr.578 /2018);
- Ligj nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;
- Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;
- Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
- Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Familjes ;
- Kodi i Drejtësisë Penale Për të Mituritt
- Kodi i Punës

---

<sup>4</sup>[http://kshb.gov.al/wp-](http://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2015/02/KONVENTA_PER_MBROJTJEN_E_TE_DREJATVE_TE_FEMIJES.pdf)

[content/uploads/2015/02/KONVENTA PER MBROJTJEN E TE DREJATVE TE FEMIJES.pdf](http://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2015/02/KONVENTA_PER_MBROJTJEN_E_TE_DREJATVE_TE_FEMIJES.pdf)

<sup>5</sup>[https://adrf.al/images/publications/LIGJI\\_108-2012-](https://adrf.al/images/publications/LIGJI_108-2012-)

[Per Ratifikimin e Konventes per te drejtat e personave me aftesi te kufizuara.pdf](https://adrf.al/images/publications/LIGJI_108-2012-Per_Ratifikimin_e_Konventes_per_te_drejtat_e_personave_me_aftesi_te_kufizuara.pdf)

## Politike e Mbrojtjes së Fëmijëve përmban:

1. **Emërimin e referentit të shkollës dhe certifikimin e konformitetit** për këtë Politikë të Mbrojtjes nga **KKEKSH**.
2. **Deklaratë angazhimi për mbrojtjen e të miturve dhe të rinjve** nga ana e shkollës e cila parashikon marrjen përsipër të angazhimeve ndaj të miturve dhe të rinjve për sa i përket parandalimit të çdo lloj forme abuzimi ose rreziku ndaj të miturit. E bashkangjitur më poshtë:



REPUBLIKA SHQIPËRISË  
GJIMNAZI PRIVAT "Atë Pjetër Meshkalla"  
SHKODER



Prot. Nr. 584/1912

### Deklarata e politikave, angazhimet dhe vlerat

1. Gjimnazi Privat "Atë Pjetër Meshkalla" merr përsipër të miratojë një politikë për mbrojtjen e të miturve në përputhje me Politikën e miratuar nga KKEKSH, duke ditur se respektimi i saj është një kërkesë e domosdoshme për të vazhduar të jetë pjesë e rrejtës.
2. Shkolla "Atë Pjetër Meshkalla" pranon të marrë Auditim nga KKEKSH me qëllim verifikimin e pajtueshmërisë me Politikën.
3. Shkolla "Atë Pjetër Meshkalla" merr përsipër të zbatojë të gjitha ligjet në lidhje me të drejtat e të miturve, pa përjashtim.
4. Shkolla "Atë Pjetër Meshkalla" merr përsipër të mos fshehtë asnjë fakt që mund të cilësohet si abuzim mbi të mitur, sipas përkufizimeve të përmbajtura në *Politikën* e miratuar nga KKEKSH, ndaj angazhohet për ta menaxhuar atë në mënyrë transparente, në përputhje me procedurat e parashikuara nga kjo *Politikë* dhe marrjen e masave të duhura, masa kundrejt punonjësve të saj që mund të kenë bërë shkelje të ligjit ose të rregulloreve të brendshme të shkollës të miratuara në përputhje me këtë *Politikë*.
5. Këto masa, në varësi të rasteve, përfshijnë ndërprerjen e bashkëpunimit, sanksionet jodefinitive, kërkesat për kompensim/rimbushim, raportim tek autoriteti publik dhe, për rregulltarët gjithashtu edhe sanksione të parashikuara nga e drejta kanonike universale dhe e veçantë.
6. Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejta të barabarta. Asnjë fëmijë apo i ri, nuk duhet të dëmtohet për shkak të gjinisë, ngjyrës, gjuhës apo besimit të tij.
7. Fëmijët dhe të rinjtë kanë të drejtën e informimit, shprehjes së mendimit të tyre dhe të drejtën për t'u dëgjuar.
8. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën apo zhvillimin e tij normal.
9. Interesat më të larta të çdo të mituri duhen mbrojtur me çdo kusht, duke përfshirë edhe përkrahjen dhe promovimin e të drejtave të tyre.
10. Parimi themelor i punës me të miturit është që ata duhet të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur. Mirëqenia dhe interesi më i lartë i tyre është përparësia jonë kryesore.

Data: 19.12.2019

President i Këshillit Administrativ

Zef Bisha S.I.  




Drejtori i Gjimnazit "Atë Pjetër Meshkalla"  
Giangiacomo Ghiglia S.I.



3. **“Plan vigilance”** brenda ambienteve shkollore e cila garanton një vigjilencë korrekte dhe të vazhdueshme mbi të miturit, edhe në lidhje me grup moshat e ndryshme.
4. **“Vlerësim i riskut”**, e cila hartohet për çdo vit shkollor duke mbajtur parasysh rezultatet e analizës paraprake të kontekstit të shkollës, të territorit ku ajo ndodhet, të tipologjisë së të miturve dhe të rinjve, të moshës së tyre, të statistikave të periudhës së fundit (të paktën në tre vitet e fundit) të cilat mund t’u referohen pikave kritike (*denoncimeve, dënimeve, kërkesave për dëmshpërblim, hetimeve nga organet kompetente, sinjalizimeve të familjeve, sondazheve të mediave, aksidenteve që kanë përfshirë të miturit, helmimeve ushqimore etj.*) të lidhura me argumentet që trajton politika e mbrojtjes.
5. Hartimin periodik të një **Plani Vjetor** të masave të mbrojtjes së të miturve dhe të rinjve që të jetë koherent me rezultatet e vlerësimit të rrishtit dhe që ka për qëllim të promovojë si parandalimin e çdo forme të mundshme abuzimi ndaj të miturve dhe të rinjve.
6. **Përzgjedhja e stafit (Check list)** - përcakton një procedure të posaçme për të punësuar personelin që punon në kontakt me të miturit dhe të rinjtë.
7. **Rregullore e brendshme** e shkollës ku përmban hartimin e një rregulloreje të shkollës që vë para përgjegjësisë të gjithë nxënësit.
8. **Kodi i Sjelljes** për stafin mësimor dhe jo mësimor, e cila përmbante gjitha normat e sjelljes për të garantuar respektimin e kësaj Politike të Mbrojtjes, mbi bazën e modelit të përbashkët.
9. **"Rregullore për vizitorët"** një dokument që nënshkruhet dhe duhet të respektohet nga çdo person tjetër që mund të ketë kontakt me fëmijën brenda ambienteve të institucioneve arsimore, qofshin ata rregulltarë, punëtorë të kontraktorëve, punonjës, vullnetarë, bashkëpunëtorë ose përfaqësuesit e palëve të treta që vizitojnë institucionin, i cili duhet të dorëzohet për nënshkrim me hyrjen e parë në institucionin arsimor.
10. **Deklaratë konfidenciale** – për punonjësit dhe vullnetarët mbi **mbrojtjen e të dhënave personale**.
11. **Trajtimi i të dhënave personale** – firmosur nga prindi ose kujdestari ligjor mbi garantimin e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

12. **Trasparenca** - Komunikimin e masave, që janë marrë për të garantuar mbrojtjen e miturve dhe të rinjve sipas parimit të transparencës, të gjithë aktorëve drejtpërdrejtë të interesuar.
13. **Procedura për parandalimin dhe trajtimin e bullizmit dhe bullizmit kibernetik** - Procedura përshkruan metodat e zbatuara mbi parandalimin dhe trajtimin e bullizmit dhe bullizmit kibernetik në gjimnaz.
14. **Procedurat e menaxhimit të rastit** për të dalluar dhe menaxhuar problematikat të lidhura me mbrojtjen e të miturve dhe të rinjve, që ka për qëllim t'u mundësojë të gjithë të interesuarve sinjalizimin, edhe në formë të rezervuar, të çdo akti të ndaluar me ligj ndaj të miturve dhe të rinjve, të situatave të rrezikut për sigurinë e tyre si dhe të mbajë nën kontroll masat e marra për parandalimin ose menaxhimin e tyre.
15. **Mekanizmi i referimit** - Në këtë dokument ekziston një mekanizëm i qartë i referimit. Ky mekanizëm i referimit parashikon dy figura profesionale që janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e menaxhimit të rastit, dhe një Këshill Vigjilence nga KKEKSH i cili vepron si "garantuesi" i zbatimit të politikave dhe menaxhimit të rasteve.
16. **Rregullore mbi shëndetin e nxënësve – Plan veprimi për ndihmën e parë shëndetësore.**
17. **Formimin fillestar dhe të vazhdueshëm** të të gjithë personelit shkollor që operon në kontakt me të miturit dhe të rinjtë për të garantuar njohjen dhe kuptimin e rregullave të parashikuara në këtë Politikë.

Në gjimnazin "Atë Pjetër Meshkalla" është emëruar referente për mbrojtjen e fëmijëve, psikologia e shkollës Estela Pemaj.

**Kontakt:**

**Email:** [mbrojtja.femijeve@meshkalla.edu.al](mailto:mbrojtja.femijeve@meshkalla.edu.al)

**Cel:** +355 736 6354





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJIMNAZI PRIVAT “Atë Pjetër Meshkalla”  
SHKODER



## Model për sinjalizime tek Referenti

**Datë:** \_\_\_\_\_

**Emër dhe mbiemër:** \_\_\_\_\_

(fakultativ)

### Detyra/pozicioni

- nxënës
- familjari i nxënësit
- rregulltar
- punonjësit
- bashkëpunëtor i jashtëm

### Informacione personale (në rast të sinjalizimi jo anonim)

**Kontakte:** \_\_\_\_\_

**Tel:** \_\_\_\_\_

**E-mail:** \_\_\_\_\_

### Qëllimi i raportimit:

Ju lutemi jepni përshkrime dhe detaje rreth ankesës suaj:



1) Çfarë ka ndodhur:

---

---

---

2) Kur (data dhe koha ): \_\_\_\_\_

3) Kush ishte i pranishëm:

---

---

---

4) A ka ndodhur kjo më parë :

- po
- jo

Nëse po, jepni detaje:

---

---

---

5) Cilat janë rezultatet apo masat, që pretendoni në përfundim të ankesës suaj:

---

---

---

---

6) A keni ndonjë informacion tjetër që duhet të përmendni ose të përfshini në ankesën tuaj;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJIMNAZI PRIVAT “Atë Pjetër Meshkalla”  
SHKODER



---

---

---

---

**Nënshkrimi i ankuesit (në rast sinjalizimi jo anonim):** \_\_\_\_\_

**Nënshkrimi i Referentit:** \_\_\_\_\_